

SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

KOMENTE MBI DRAFT LIGJIN

“PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME”

29 qershor 2021

I. Konteksti i duhur për diskutimin e projekt-ligjit *“Për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme”*

- Projekt-ligji është përgatitur dhe po diskutohet në një spektër kohor me *“Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027”*, objekt diskutimi, konsultimi me grupet e interesit edhe në mbledhjen më të fundit të KI në 21 Qershor 2021- duke qenë edhe pjesë e planit të veprimit të kësaj të fundit.
- Ka një nevojë në rritje për mbështetjen e NMVM me masa mbështetëse/ndihmë shtetërore dhe kryesisht akses në financë/grante (tema të trajtuara në mbledhje të dedikuara të KI dhe analiza të detajuara nga Sekretariati) në funksion të rritjes së konkurrueshmërisë së tyre. Të gjitha këto janë elemente përbërës në kuadrin e shtyllës së parë të Strategjisë- *Tërheqja e Investimeve dhe Ndërkombëtarizimi*.
- Nga ana tjetër është e domosdoshme promovimi dhe ndërgjegjësimi i masave mbështetëse dhe skemave të mbështetjes financiare të disponueshme për ndërmarrjet- momentum i krijuar nga prezantimi i portalit elektronik për instrumentet financiare të krijuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe me partnerët për zhvillim (*parashikim në Nenin 11 pika 7*), i zhvilluar nga AIDA në bashkëpunim me BERZH. Në këtë kuptim masat konkrete të realizuara të cilat duken si i kanë paraprirë projekt-ligjit janë një praktikë pozitive.
- Plotësimin e mangësive të cilat lidhen me disa aspekte ligjore të ligjit 8927/2002 *“Për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme”* dhe konkretisht me përcaktimin e detyrimeve të qarta ligjore mbi menaxhimin e fondit të mbështetjes buxhetore, të cilat janë akomoduar në nenin 11, pikat 3 dhe 4.

II. Kuadër ligjor më i mirë në raport me ligjin 8957/2002, por disa parashikime kanë nevojë për përmirësime.

A. Terma

- Titulli i Projekt-ligjit reflekton në mënyrë korrekte terminologjinë e Rekomandimit të Komisionit European 2003/361/EC, publikuar në Fletoren Zyrtare të BE L 124, p. 36 of 20 May 2003. Në dallim nga Ligji 8957/2002, këtu përfshihet në emërtim edhe termi *“Mikro ndërmarrje”* duke evidentuar rolin në rritje të të vetëpunësuarve në ekonominë e vendit.
- (Neni 2)-Përkufizimet janë përgjithësisht të harmonizuara me Rekomandimin e Komisionit European 2003/361/EC.

- Përkufizimi (3) *Shifër afarizmi* është e harmonizuar edhe me kuptimin e konceptit sipas Standardit Kombëtar të Kontabilitetit (SKK 15).
 - Përkufizimi (6) Nuk është e qartë se cilat janë “rajonet” mbi të cilat bën referencë përkufizimi 6- “fonde të zhvillimit rajonal”, në një kohë që Shqipëria është e ndarë në qarqe. Nëse përkufizimi bëhet mbi bazën e “rajoneve” të përcaktuara në ndonjë ligj specifik, atëherë, pika 6 duhet të bëjë referencë në bazën përkatëse ligjore.
 - Përkufizimi (8) *“biznese të palistuara- business angels”* është një koncept relativisht shumë i ri në kontekstin shqiptar. Konstatohet që përkufizimi i *business angels* në këtë projekt-ligj është i ndryshëm nga përkufizimi i këtij koncepti në projekt-ligjin *“Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-up Inovative”* sipas të cilit *Ëngjëll Biznesi* është: - një investitor i cili me përvojën dhe me fondet e tij, ka kryer një investim kapitali në fazën fillestare të zhvillimit, në të paktën dy Startup-e Inovative. Nisur nga sa më sipër është e nevojshme që për konsistencë terminologjike, teknikë legjislative dhe kuptim të qartë nga subjektet e tij, përkufizimi i *Ëngjëll Biznesi* të jetë i njëjtë në këto të dyja këto projekt-ligje.
 - (Neni 4)- Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë *mot à mot* sipas përcaktimeve të Rekomandimit të Komisionit dhe Aneksit të tij, nenet 2 dhe 3. Megjithatë për qëllime praktike në pikën 5 ka nevojë për disa ndërhyrje: Konkretisht:
 - “0 deri 1 persona”, sugjerohet të zëvendësohet me: “të vetëpunësuarit” sipas terminologjisë të përdorur gjerësisht në fushën tatimore.
 - “0-9 persona” sugjerohet të shkruhet: “deri në 9 persona”.
 - (Neni 11 pika 7) Çdo institucion që ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ngarkohet që brenda 5 ditëve përpara fillimit të zbatimit të skemës të paraqesë informacion pranë AIDA.
- Pyetje: (1) A parashikohen edhe donatorët këtu? (2) Afati kohor është një instrument monitorues shumë i mirë, por a është menduar se si do të vihet mekanizmi në lëvizje për të mundësuar përditësimin në kohë të informacionit nga institucionet dhe donatorët?*
- (Neni 9)- Nuk është e qartë se çfarë d.m.th në terma praktikë *“akses gjinor i balancuar”* dhe as nuk parashikohet diku tjetër në projektligj, që ky koncept do të përcaktohet me ndonjë akt nënligjor tjetër.
 - (Neni 10)
 - Sugjerohet që të përdoret termi: *“partnerët për zhvillim”* në vend të *“donatorët”*
 - Në paragrafin 1 pika c) togfjalëshi *“ligjit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore”* sugjerohet të rishikohet. Kjo terminologji nuk është e qartë dhe sugjerohet të ndryshohet përkatësisht. Emërtimi i ligjit për të cilin bëhet referimi është *Ligji Nr. 9665, Datë 18.12.2006, “Për Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror Dhe Garancitë Shtetërore Të Huas Në Republikën E Shqipërisë”*.

B. Njohja e ligjit nga ndërmarrjet/Informimi

- (Neni 5)- Konceptet e trajtuara në këtë nen janë relativisht të reja dhe jo lehtësisht të kuptueshme nga subjektet e këtij ligji- pavarësisht se janë përkthime të dispozitave të Rekomandimit të Komisionit dhe Aneksit të tij. Megjithatë do të ishte e sugjerueshme, që

ligji të pasohet edhe me përgatitjen e një Udhërrëfytyrës sipas modeleve të Komisionit të cilat sqarojnë në terma më të thjeshta, kushtet, kriteret dhe kategoritë në lidhje me “ndërmarrjet autonome” dhe “ndërmarrjet partnere”. Modeli që mund të ndiqet për këtë Udhërrëfytyrë është në këtë link: https://ec.europa.eu/regional_policy/sources/conferences/state-aid/sme/smedefinitionguide_en.pdf

C. Programet e mbështetjes dhe unifikimi i kriterëve

- (Neni 11)- Në vijim edhe të komenteve të Sekretariatit të KI mbi BIDS 2021-2027 këtu duhen cilësuar shprehimisht (në pikën 2) edhe programet e mbështetjes për “*digital*” dhe “*green transition*” të cilat janë në qendër edhe të Politikës Industriale të BE 2020, ndryshuar në Maj 2021.
- (Neni 11 pika 5)- Cili është argumenti për këtë afat kohor minimal të ekzistencës si person fizik apo juridik? - sepse nuk jepet ndonjë sqarim në Relacion, RIA apo Dokumentin Konsultativ. Kriteret e përgjithshme megjithatë janë të harmonizuara dhe shteruese duke kufizuar diskrecionin për vendosjen e kriterëve të tjera në vijim të cilat mund rritin burokracinë administrative.
- (Neni 11 pika 6)- Përcaktimi “*rust pas rasti*” nuk është i qartë dhe lë vend për interpretime të ndryshme. Cili është kuptimi? Ligji duhet të mundësojë për aq sa është e mundur kushte kriteret dhe msa përfitimi të unifikuara dhe jo rast pas rasti.
- (Neni 13)- titulli duhet rishikuar. Sugjerohet që togfjalëshi “institucionet shtetërore” të zëvendësohet me “njësitë e vetëqeverisjes vendore” sepse neni referon vetëm tek këto dhe jo tek cdo institucion shtetëror.
- (Neni 15)- Kjo është një dispozitë me karakter deklarativ dhe shumë blankete. A është menduar ndonjë mekanizëm konkret partneriteti që i bën njësitë e vetëqeverisjes vendore si institucione të interesuar për të mbështetur NMVM, në kushtet kur burimet e tyre njerëzore dhe financiare aktuale janë të kufizuara?

D. Transparenca dhe kuadri rregullator/institucional

- (Neni 16)- Në funksion të transparencës dhe llogaridhënies institucionale por edhe të praktikave të mira të qeverisjes, sugjerohet vendosja si detyrim ligjor e publikimit të këtyre raporteve vjetore për publikun. Pra, AIDA/MFE të bëjnë publikimin e raportit vjetor të vitit pararendës në faqen/t zyrtare në internet jo më vonë se data 15 korrik.
- (Neni 19)- Neni sugjerojmë të riformulohet duke ndryshuar rrënjësisht mekanizmin e këshillit konsultativ. Parimisht, KK si organ këshillimor pranë institucionit përgjegjës për ekonominë- nuk mund të kompozohet me shumicën e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore. Kjo krijon një konfuzion konceptual pasi institucionet shtetërore këshillojnë një institucion tjetër shtetëror. Sugjerohet që mekanizma të tillë të ndjekin praktikën e mira të “good governance” dhe të cilat garantojnë “check” and “balance” të kuadrit rregullator

dhe një format përfaqësimi në shumicë të sektorit privat- ndërmarrjeve si partnerë drejtpërdrejtë të interesuara për monitorimin dhe zbatimin e ligjit për NMVM. Nga ana tjetër mekanizmi duhet të mundësojë edhe një rotacion të anëtarëve nga radhët e biznesit/kategorive të ndërmarrjeve në mënyrë që të sigurohet gjithëpërfshirje dhe zë i gjerë përfaqësimi.

Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet - konsiderohet strukturë këshilluese për rritjen e aksesit të NMVM në fonde etj, sikurse edhe një sërë këshillash apo grupesh ndërinstytucionale ekzistuese. Objekti kryesor i tyre është rritja e besimit të paleve ndaj institucioneve përsa kohë që ka angazhim dhe raportim dypalësh, por rreziku i shtimit të instrumentave të tillë rrit edhe vëllimin e punës për analizë dhe raportim si pjesë e besueshmërisë - ndaj si mendohet nga ana institucionale angazhimi ndaj shtimit të instrumentave të tillë për të stimuluar besimin? A ka nevojë për një qasje të standardizuar për të rritur besimin në gjithë-përfshirje dhe menaxhuar me mire boom të platformave të tilla?